




REPUBLIKA E KOSOVËS  
REPUBLIKA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVA

KOMISIONI I PAVARUR I MEDIAVE  
NEZAVISNA KOMISIJA ZA MEDIJE  
INDEPENDENT MEDIA COMMISSION



Z. Abdullah Etemi  
Anëtar i Kryesisë së Bashkimit Demokratik  
Prizren

Prishtinë, 10 tetor 2013

Ref: 1310/1343/LEG/hzg

I nderuari z. Etemi,

Komisioni i Pavarur për Media me datën 08.10.2013, nëpërmes PZAP, ka pranuar një ankesë nga partia Bashkimi Demokratik, sipas ankesës, "Zyrtari për informim i Bashkimit Demokratik, më datën 2 tetor 2013 ka njoftuar Radio Televizionin e Kosovës për agjendën e partisë, e veçanërisht për hapjen e fushatës zgjedhore të BD-së në Prizren dhe Dragash (Sharr). Mirëpo, RTK nuk i është përgjigjur ftesës në asnjërin rast dhe as nuk ka bërë transmetimin e fushatës në emisionet informative."

Në sqarimin e RTK-së thuhet që ata e kanë përcjellë "aktivitetin e këtij subjekti dhe mbi të gjitha është pasqyruar në përmbledhjen zgjedhore në kuadër të edicionin qëndror të lajmeve të orës 19:30 dhe po ashtu në kronikën zgjedhore, edicion ky i veçantë i cili wshtw transmetuar rreth orës 22:30 në datën 3 tetor 2013. Ndërkaq, i njejt i është ri-transmetuar edhe në kuadër të Programit të mëngjesit "Mirëmëngjesi Kosovë" ditën e nesërme." Këto të dhëna edhe janë dëshmuar me dokumente nga RTK.

Po ashtu, bazuar në monitorimet e bëra nga Departamenti i Monitorimit dhe Analizave i KPM-së për mbulimin e fushatës zgjedhore në RTK, është gjetur se ankesa e Bashkimit Demokratik është e pa bazuar. Pasiqw RTK ka mbuluar hapjen e fushatës se këtij BD-sw në Prizren. Kështu, në edicionin qëndror të lajmeve të 03 tetorit, BD është mbuluar me 1' e 7" ndërsa, në kronikën zgjedhore të po asaj dite i është dhënë hapësire prej 1' 24 ''.

Duke u bazuar në këto të dhëna Departamenti Ligjor i Komisionit të Pavarur për Media vjen në përfundim që ankesa juaj është e pabazë dhe se RTK nuk ka bërë shkelje, pasiqë ka transmetuar aktivitetin e subjektit tuaj politike.



Me respekt,  
Liridon Dalipi  
Drejtore i Departamentit Ligjor

Komisioni i Pavarur i Mediave/Nezavisna Komisija za Medije/Independent Media Commission  
Rr.Ul.Str. Perandori Justinian Nr. 14 Qyteza Pejton, 10000 Prishtinë-Priştin- Pristina/Kosovë-Kosovo

Tel: (+381) (0) 38 245 031

Fax: (+381) (0) 38 245 034

E-mail: [Info@kpm-ks.org](mailto:Info@kpm-ks.org);

[www.kpm-ks.org](http://www.kpm-ks.org);